



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008; nenit 3 dhe 4 Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB- 03/2012 për Këshillat Komunale për siguri në bashkësi dhe nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dates 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen me 04. 04. 2016, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës miratojë këtë

**V E N D I M**  
**PËR ZËVENDËSIMIN DHE PLOTËSIMIN E KATËR ANËTARËVE TË KËSHILLIT**  
**KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI –KKSB-së**

**Neni 1**

**Zëvendësimi i anëtarëve të KKSBS-së**

1.Me këtë Vendim në pikën I të Vendimit për themelimin e KKSBS në Komunën e Lipjanit 15Nr.020-3393 i datës 29.01.2014 zëvendësohen dhe plotësohen anëtarët e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi si vijon:

- 1.1 Në numrin rendor 3, caktohet **Xhevdet Bytyqi** në vend të Vehbi Gajtani nga Bashkësia Islame,
- 1.2 Në numrin rendor 4 caktohet **Serdjan Stankoviq** në vend të Gjorgje Stefanoviqit nga Kisha Ortodokse,
- 1.3 Numri rendor 5 plotësohet përkatësisht caktohet **Don Matej Palic** nga kisha katolike,
- 1.4 Numri rendor 12 plotësohet përkatësisht caktohet **Boban Jovanoviq**, kryesues i komitetit për komunitete.

**Neni 2**

**Detyrat, përgjegjësitë, mandati dhe kompensimi**

Detyrat , përgjegjësitë, mandati dhe kompensimi i anëtarëve të KKSBS-në është i përcaktuar me dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB- 03/2012 për Këshillat Komunale për siguri në bashkësi dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës për Themelimin e KKSBS në Komunën e Lipjanit 15Nr.020-3393 të datës 29.01.2014.

**Neni 3**

**Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë së administrimit të Pushtetit lokal dhe publikimit në WebFaqen e Komunës.

15Nr. 020-17244  
Lipjan, më 05. 04. 2016

**KUVENDI I KOMUNËS SË LIPJANIT**

**KRYESUESJA E KUVENDIT**  
**Vlora Limani-Hajnuni**

